



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "ASTREA"

Nr.8517 Prot.

Tiranë, më 05.03.2020

Nr.37-20 Regj.

**URDHËR**

**VENDOSJE SEKUESTRO KONSERVATIVE**

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit

**TIRANË**

**Për dijëni:** Debitorit – Shoqëria "ABA CONSTRUCTION" Shpk me NIPT L82305020C

Adresa: Me shpallje në QKB.

**Për dijëni:** Kreditorit – Shoqëria "LOAL PETROLEUM" sh.a me Nipt: L81731018P

Adresa: TIRANE Rruga Ferit Xhajko, godina 57/1, hyrja 3, apartamenti 29

Unë, Ardit Hajdini, Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "ASTREA" shpk Nipt: L61306025U, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.9341 Akti, datë 25.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.37-20, datë 20.01.2020 kërkesën e kreditorit Shoqëria "LOAL PETROLEUM" sh.a me Nipt: L81731018P ndaj debitorit Shoqëria "ABA CONSTRUCTION" Shpk me NIPT L82305020C në lidhje me Titullin Ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje Nr.Serie 69017867, Nr.867 datë 16.04.2019 dhe Nr. Serie 68969902, Nr.902 datë 12.03.2019.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr.8059 Prot, Datë 23.01.2020, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhëri i Ekzekutimit Nr.9341 Akti, datë 25.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

**KONSTATOVA Se :**

Adresa: Rr. "Kajo Karafili", Pll.pas Lidhjes se Shkrimtareve, H.1, Kati 2, Tiranë Cel +355 676950155  
e-mail : [sherbimipermbarimorastrea@gmail.com](mailto:sherbimipermbarimorastrea@gmail.com)

Me shkresën Nr.8059 Prot, datë 23.01.2020, është bërë “Lajmërimi për ekzekutim vullnetar të detyrimit” dhe pasi pala debitore nuk ka marrë dijeni një adresë që kishim në dispozicion, është vijuar me Shkresën Nr.8326 Prot, datë 11.02.2020 drejtuar QKB-së e cila ka bërë Shpalljen e “Lajmërimin për Ekzekutim Vullnetar të Detyrimit” Nr.8059 Prot, datë 23.01.2020.

Në këto kushte, në zbatim të nenit 36 të ligjit Nr.26/2019 miratuar në datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

#### URDHËROJ:

1. Qendra Kombëtare e Biznesit të vendosë sekuestro konservative mbi aktivet e shoqërisë:
  - **Shoqëria “ABA CONSTRUCTION” Shpk me NIPT L82305020C, deri në një njoftim të dytë të përmbaruesit gjyqësor.**
2. Qendra Kombëtare e Biznesit të na dërgojë një ekstrakt të kesaj shoqërie.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht *brenda afatit ligjor.*
4. Personat që bëhen pengesë, *do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.*
5. Kundër këtij urdhëri *lejohet ankim* në Gjykatë, brenda *5(pesë) ditëve*, nga dita e marrjes dijeni.

**ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “ASTREA”  
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT  
ARDIT HAJDINI**

